



**UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
FAKULTETI I EDUKIMIT**

Rr. Agim Ramadani, Fakulteti i Edukimit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +383 38 229 201 • E-mail: edukimi@uni-pr.edu • edukimi.uni-pr.edu

Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" Fakulteti i Edukimit

Programi i studimit:
Programi Fillor

Niveli i studimeve:
Bachelor

Numri i kredive:
240 ECTS

Akredituar për periudhën:
1 Tetor 2021 - 30 Shtator 2024

PËRMBAJTJA

1. QËLLIMI DHE PROFILI I PROGRAMIT TË STUDIMIT	3
2. REZULTATET E PRITURA TË PROGRAMIT	4
3. PROGRAMI STUDIMOR: Programi Fillor	5
4. PËRSHKRIMET E KURSEVE	8

1. QËLLIMI DHE PROFILI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Qëllimi i programit Fillor është t'u ofrojë studentëve njohuri, aftësi dhe vlera të nevojshme për të kryer profesionin e mësuesit në arsimin fillor. Programi synon të pajisë studentët me njohuritë e përmbajtjes kurrikulare për nivelin e dhënë dhe me njohuritë dhe aftësitë pedagogjike të nevojshme për të dhënë një mësimdhënie efektive. Programi synon t'u mundësojë studentëve që të jenë të përgatitur për të përballuar detyrat dhe pritjet e profesionit të mësuesit, duke përfshirë të kuptuarit e mjedisit të përshtatshëm të të mësuarit, planifikimin dhe zhvillimin e kurrikulës, si dhe kuptimin e faktorëve që ndikojnë në të mësuarit e suksesshëm. Programi synon të përgatisë mësues të rinj që të jenë të gatshëm të kontribuojnë në zhvillimin e shkollës dhe profesionit të mësuesit duke ndjekur trendet bashkëkohore në mësimdhënien cilësore duke përfshirë integrimin e teknologjisë dhe përshtatjen e mësimdhënies së tyre me specifikat e studentëve.

Misioni i programit Fillor është në përputhje me deklaratën e përgjithshme të misionit të Fakultetit. Misioni i programit është të sigurojë një program cilësor për përgatitjen dhe trajnimin e vazhdueshëm të mësuesve, të cilët janë të gatshëm të kontribuojnë në zhvillimin e shkollës dhe profesionit të mësuesit.

2. REZULTATET E PRITURA TË PROGRAMIT

Në përfundim të studimeve, të diplomuarit do të jenë në gjendje të:

- Kuptojnë fenomenet dhe konceptet teorike për të mësuarit dhe edukimin e nxënësve;
- Planifikojnë, zbatojnë dhe vlerësojnë procesin mësimor sipas planifikimit të kurrikulës;
- Ndjekin dhe integrojnë inovacionet në fushën e mësimdhënies
- Integrojnë teknologjisë dixhitale në procesin e mësimdhënies dhe të të nxënit
- Përshtasin mësimdhënien e tyre me stilet dhe specifikat të ndryshme të të mësuarit, përfshirë aftësinë për të dhënë mësim të diferencuar;
- Demonstrjnë aftësi të të menduarit bazuar në të menduarit shkencor, përfshirë aftësinë e tyre për t'u përfshirë në punë kërkimore për të përmirësuar praktikat e tyre të mësimdhënies;
- Demonstrjnë se ata i trajtojnë nxënësit si qenie njerëzore të afta të përjetojnë mjedisin e tyre nga një dimension holistik;
- Demonstrjnë një kuptim të sistemit të vlerave që sistemi arsimor parauniversitar i Kosovës synon të arrijë dhe janë në gjendje t'i lidhin ato me procesin e mësimdhënies;
- Sigurojnë mundësi për qasje gjithëpërfshirëse në procesin e zbatimit të planit dhe programit, duke i dhënë mundësi të barabarta secilit;
- Planifikojnë dhe zbatojnë vlerësimin e bazuar në kompetenca duke përfshirë lloje të ndryshme të vlerësimit formativ dhe përmblëdhës.
- Përgatisin mjedisin për të siguruar ndërveprime midis fëmijëve, ndërveprime midis fëmijëve dhe të rriturve dhe për të krijuar mundësi për integrim ndërfushor.
- Hartojnë dhe zbatojnë qasje të ndryshme për partneritetet me familjen dhe komunitetin;

3. PROGRAMI STUDIMOR: Programi Fillor

VITI I PARË - PROGRAMI FILLOR					
SEMESTRI I					
Kursi	O/Z	Emri i kursit	L	U	ECTS
1	O	HYRJE NË EDUKIM	3	1	6
2	O	GJUHË SHQIPE I	3	1	6
3	O	MATEMATIKË I	3	1	6
4	O	GJUHË ANGLEZE I	3	1	6
5	O	EDUKIMI FIZIK DHE SPORTET	3	1	6
			15	5	30
1	O	TEORI E MËSIMIT	3	0	5
2	O	PSIKOLOGJI ZHVILLIMORE ME PRAKTIKË I	3	0	5
3	O	GJUHË SHQIPE II	3	1	6
4	O	HISTORI KOMBËTARE	3	0	5
5	O	EDUKATË MUZIKORE ME METODOLOGJI	3	0	5
6	Z	SHKATHTËSITË E STUDIMIT AKADEMIK	2	0	4
7	Z	KOMUNIKIMI NË ARSIM	2	0	4
8	Z	DREJTSHKRIMI I SHQIPES	2	0	4
9	Z	GJUHË ANGEZE II	2	0	4
10	Z	EDUKIMI PËR MEDIA	2	0	4
			17	1	30

VITI I DYTË - PROGRAMI FILLOR					
SEMESTRI III					
Kursi	O/Z	Emri i kursit	L	U	ECTS
1	O	SHKENCAT SHOQËRORE ME METODOLOGJI	3	1	6
2	O	GJUHË SHQIPE III	3	1	6
3	O	TIK NË EDUKIMIN FILLOR	3	1	6
4	O	METODIKA E EDUKIMIT FIZIK	2	1	4
5	O	INTERPRETIMI NË INSTRUMENTE	2	1	4
6	Z	EDUKIMI PËR QYTETARI DEMOKRATIKE	2	0	4
7	Z	MËSIMI JASHTËKURRIKULAR	2	0	4
8	Z	STRATEGJITË DHE METODAT E SHKRIM LEXIMIT	2	0	4

9	Z	METODOLOGJIA MONTESORI	2	0	4
10	Z	EDUKIMI PËR NDËRMARRËSI	2	0	4
			15	5	30
	O	PRAKTIKË PEDAGOGJIKE II	3	0	5
1	O	LETËRSI PËR FËMIJË	3	0	5
2	O	SHKENCAT E NATYRËS ME METODOLOGJI I	3	1	6
3	O	MATEMATIKE II	3	1	6
4	Z	DRAMATIZIMI DHE SHFAQJET ME KUKULLA	2	0	4
5	Z	QYTETËRIMI SHQIPTAR	2	0	4
6	Z	EDUKIMI SHËNDETËSOR	2	0	4
7	Z	EDUKIMI NË FËMIJËRINË E HERSHME	2	0	4
8	Z	SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT ME FËMIJË	2	0	4
			16	2	30

VITI I TRETË - PROGRAMI FILLOR					
SEMESTRI V					
Kursi	O/Z	Emri i kursit	L	U	ECTS
1	O	BAZAT E HULUMTIMIT NË EDUKIM	2	2	6
2	O	PSIKOLOGJI E EDUKIMIT	2	1	5
3	O	PRAKTIKË PEDAGOGJIKE III	3	0	5
4	O	ARTET FIGURATIVE ME METODOLOGJI	3	1	6
5	Z	SHKOLLA FAMILJA DHE KOMUNITETI	2	0	4
6	Z	STRATEGJITË BASHKËKOHORE TË MËSIMDHËNIES	2	0	4
7	Z	SHKATHTËSITË PËR JETË	2	0	4
8	Z	METODOLOGJI E LEXIMIT LETRAR	2	0	4
9	Z	HISTORI E ARSIMIT KOMBËTAR	2	0	4
			14	4	30

Kursi	O/Z	Emri i kursit	L	U	ECTS
1	O	EDUKIMI GJITHËPËRFSHIRËS	3	0	5
2	O	SHKENCAT E NATYRËS ME METODOLOGJI II	3	1	6
3	O	MËSIMDHËNIA E MATEMATIKËS I	3	1	6
4	O	METODOLOGJI E GJUHËS DHE LETËRSISË SHQIPE	3	0	5
5	Z	STATISTIKË ELEMENTARE	2	0	4
6	Z	PROCESET PSIKIKE DHE PERSONALITETI	2	0	4
7	Z	MËSIMDHËNIA E DIFERENCUAR DHE PIA	2	0	4
8	Z	ETNOLOGJI DHE LETËRSI POPULLORE	2	0	4
9	Z	MËSIMI NË NATYRË	2	0	4
			16	2	30

**Viti i katërt - Programi Fillor
Semestri VII**

Kursi	O/Z	Emri i kursit	L	U	ECTS
1	O	VLERËSIMI NË ARSIM	2	1	5
2	O	LETËRSI KOMBËTARE	3	1	6
3	O	MËSIMDHËNIA E MATEMATIKËS II	3	1	6
4	O	EDUKIMI PËR ZHVILLIM TË QËNDRUESHËM	2	1	5
5	Z	VËSHTIRËSITË NË TË NXËNË	2	0	4
6	Z	MENAXHIMI I KLASËS	2	0	4
7	Z	EDUKIMI PËR STEAM	2	0	4
8	Z	ZHVILLIMI PROFESIONAL I MËSIMDHËNËSVE	2	0	4
9	Z	LOJËRAT MATEMATIKORE	2	0	4
			14	4	30
Kursi		Emri i kursit	L	U	ECTS
1	O	FILOZOFI E EDUKIMIT	3	1	6
2	O	PRAKTIKË PEDAGOGJIKE IV	3	0	14
3	O	PROVIM PERFUNDIMTAR	6	1	10

4. PËRSHKRIMET E KURSEVE

Përshkrimi për secalin kurs

HYRJE NË EDUKIM

Kursi ka për qëllim të ofrojë për studentët një perspektivë bazike rreth çështjeve me rëndësi për profesionin dhe sistemin e arsimit në Kosovë me fokus të vecantë. Kursi fillon me definimin e nocioneve kryesore në fushën e edukimit. Tutje, kursi trajton temat si: vlerat që avokon sistemi i arsimit në Kosovë, dimensionin filozofik dhe politik i funksionimit të sistemit të arsimit në Kosovë nga perspektiva e legjislativës; parimet themelore të funksionimit të shkollës në Kosovë duke përfshirë edhe orientimet, parimet dhe politikat kurrikulare; si dhe standardet e profesionit të mësimdhënësit në Kosovë nga perspektiva e zhvillimit të shkencës rreth profesionalizimit të rolit të mësuesit si dhe rrethanat legjislative dhe profesionale në Kosovë. Kursi trajton edhe zhvillimet kyeshore në sistemet e arsimit në botë (Lëvizja Globale për Reformën Arsimore & Zhvillimi me bazë në shkollë) si dhe çështjet e interesit të vecantë për sistemin e arsimit në Kosovë si mësimet nga vlerësimet ndërkombëtare, braktisja e shkollimit, të kuptuarit dhe zbatimi i diversitetit etj.

GJUHA SHQIPE I

Përmes këtij kursi studentët do t'i zgjerojnë njohuritë e tyre paraprake përkitazi me: shqipen si gjuhë indoevropiane, prejardhjen e gjuhës shqipe, dokumentimin e saj, dialektet dhe rrugën e zhvillimit të saj. Ata do të njihen teorikisht dhe praktikisht edhe me elementet themelore të sistemit fonetiko-fonologjik dhe të normës gjuhësore: drejtshqiptimin, drejtshkrimin, dallimin e tingujve nga morfemat, klasifikimin e tingujve, nyjëtimin e tyre; për prozodinë: rrokjen, theksin, intonacionin, dukuritë fonetike etj. Po ashtu do t'i thellojnë njohuritë e tyre edhe në fushën e leksikologjisë: sinonimet, antonimet; për ligjërimet - stilet dhe regjistrat e gjuhës etj.

MATEMATIKA I

Në këtë kurs shqyrtohen koncepte themelore matematike të përzgjedhura nga tematikat kryesore matematike, siç janë numrat, algjebra, statistika dhe probabiliteti. Kursi merret me thellimin e njohurive konceptuale dhe shkathtësive procedurale në lidhje me logjikën matematike, bashkësitë, relacionet, pasqyrimet, bashkësitë numerike, ekuacionet dhe inekuacionet lineare, përqindjen, proporcionet dhe kuptimet hyrëse në statistikë e probabilitet. Fokus i veçantë i kursit është zgjidhja e problemeve kontekstuale matematike.

GJUHË ANGLEZE I

Gjuhë angleze I është kurs semestral i cili i ekspozon studentët ndaj një sërë situatash komunikative në gjuhën angleze, të cilat kanë të bëjnë me tema të ndryshme nga përditshmëria nëpërmjet të cilave studentët do të jenë në gjendje të shprehin shkathtësitë e tyre komunikuese dhe njëkohësisht t'i përmirësojnë katër shkathtësitë themelore gjuhësore: të dëgjuarit, të lexuarit, të folurit dhe të shkruarit, në funksion të rrjedhshmërisë dhe saktësisë. Temat e mbuluara gjatë kursit do të përfshijnë një llojllojshmëri të ushtrimeve gramatikore dhe të leksikut të cilat do t'u ndihmojnë studentëve të arrijnë një zotërim të kënaqshëm të gjuhës

angleze, duke pasur gjithmonë në fokus gërshetimin e kompetencës dhe performansës gjuhësore, si imperativ për zotërimin e një gjuhe të huaj.

EDUAKATA FIZIKE DHE SPORTET

Lënda ofron informacione në lidhje me Edukimit fizik dhe sportiv të fëmijët e ciklit të ulët shkollor. Përshkrimi i organizimit të orës mësimore me lojëra sportive dhe analizat korresponduese, pedagogjike janë kryesisht në funksion të krijimit të shprehive sa më të plota në drejtimin e mësimdhënies por edhe të shkëmbimit të përvojës së studentëve ndërmjet tyre. Prandaj edhe formulimi i lojërave sportive e lëvizore që përfshihen në këtë përshkrim kanë karakter tepër praktik, cka ndikon në përvetësimin e shpejtë jo vetëm për të kuptuar strukturat sportive e lëvizore por edhe objektivat dhe qëllimin e cdo loje.

Në anën tjetër forma me të cilën janë paraqitur lojërat sportive ndikon edhe në formulimin e një plani sipas kërkesave të procesit mësimor.

Duke u nisur nga mendimi që lojërat janë mjeti më i zgjedhur në fushën edukative, ky përshkrim e perqëndron vëmendjen e tij kryesisht te këto veprimtari fizike tepër interesante dhe edukative. Në këtë përshkrim me karakter teorike – praktik e kulturor njëkohësisht, tentohet për një konceptim të ri të procesit mësimor , të edukimit fizik në kategori e cikle të ndryshme shkollore.

TEORI E MËSIMIT

Kursi trajton konceptet themelore didaktike (edukata, arsimi dhe mësimi), parimet dhe rregullat didaktike e organizimit të procesit mësimor, veçoritë e mësimit dhe mësimdhënies; faktorët e mësimit, personaliteti i mësimdhënësit dhe ndikimi i tij në procesin mësimor, plani dhe programi mësimor, etapat e procesit të mësimdhënies dhe artikullimin e një situatë mësimore, teorinë e kurrikulës, zhvillimin dhe zbatimin e saj në praktikën mësimore, mësimdhënia konstruktiviste. Studentët gjithashtu do të njihen me metodat dhe format e organizimit të punës mësimore, strategjitë e reja të mësimdhënies, procesin e planifikimit të mësimit, mjetet dhe teknologjinë mësimore, ushtrimet, përsëritja produktive, përforcimi dhe detyrat e shtëpisë.

PSIKOLOGJIA ZHVILLIMORE ME PRAKTIKË I

Kursi adreson zhvillimin e gjithëmbarshtëm të fëmijës në fëmijëri të hershme dhe proceset e vazhdueshme të funksionimit psikologjik të fëmijës. Kursi shtjellon nocionet e zhvillimit të gjithëmbarshtëm të fëmijës, dhe ndërveprimet e fëmijës me individët tjerë në mjedisin ku ai jeton dhe sesi këto ndërveprime ndikojnë në zhvillimin e tij. Kursi fokusohet në aftësimin teorik dhe praktik të studentëve për të njohur/kuptuar më mirë zhvillimin e fëmijës në aspektin fizik, motorik, mendor, emocional dhe social, mënyrat e tij të reagimit, si fëmija i shfaq emocionet, si zhvillohen ato, si socializohet fëmija, si mëson fëmija, dhe si të kujdesemi për fëmijën duke ruajtur mirëqenien psikologjike të tij. Studentët mësojnë për teorinë dhe studimet sistematike të zhvillimit të fëmijës, fazat e zhvillimit nga mosha paranatale deri në përfundim të fëmijërisë, karakteristikat e vecanta të secilës fazë dhe rreziqet që shoqërohen me atë fazë. Në kuadër të lëndës parashihet që studentët të kalojnë 2 javë rresht në praktikë, me qëllim të zhvillojnë shkathtësitë e vëzhgimit për të përcjellur zhvillimin e fëmijës. Gjatë kësaj kohe bazuar në doracakun e praktikës, studentët do të përgatiten për sjelljen dhe rolin e tyre gjatë praktikës në shkollë (shih doracakun).

GJUHA SHQIPE II

Gjatë ligjëratave në kursin e gjuhës amtare (shqipe) II, e në saje edhe të të nxëniet (nga shkollimi paraprak dhe nga kursi I i gjuhës i mbajtur në semestrin paraprak), studentët do kenë mundësi t'i zgjerojnë njohuritë e tyre edhe në fushën e morfologjis., si për: objektin e studimit të morfologjisë, strukturën morfologjike të fjalës, elementet e fjalëformimit: morfemat fjalëformuese dhe trajtëformuese; pjesët e ndryshueshme të ligjëratës: emrin, (nyjat), mbiemrin, numërorin, përemrin, foljen; pjesët e pandryshueshme: ndajfoljet, parafjalët, lidhëzat, pjesëzat, pasthirrat etj

HISTORI KOMBËTARE

Lënda ofron njohuritë bazike për historisë kombëtare. Në këtë lëndë trajtohen tema të cilat kanë të bëjnë me të kaluarën historike të popullit tonë, që nga krijimi i etnosit ilirë e deri në kohën bashkëkohore. Lënda fillon nga civilizimet më të hershme të Ilirëve, për t'u lidhur pastaj me civilizimin mesjetar arbëror, si dhe ndikimet e këtij civilizimi në rrjedhat e përgjithshme europiane me theks te veçantë në periudhen e humanizmit dhe renesansës europiane. Lënda trajton, gjithashtu, ngjarjet kulturore dhe politike të rilindjes kombëtare, perudhën e shpalljes së pavarësisë, për të përfunduar me shtetin e Kosovës.

EDUKATË MUZIKORE ME METODOLOGJI

Lënda është i ndarë në dy pjesë dhe ofron njohuri dhe shkathtësi bazike muzikore të cilat do të realizohen në mënyrë teorike dhe praktike. Në pjesën e parë të këtij kursi studentët do të përvetësojnë konceptet themelore muzikore dhe do të njihen me mjetet shprehëse muzikore të cilat mundësojnë të kuptuarit e muzikes.

SHKATHTËSITË E STUDIMIT AKADEMIK

Lënda Shkathtësitë e studimit akademik është planifikuar për studentët me qëllim që të fitojnë qëndrimet dhe aftësitë e nevojshme për të qenë nxënës efektivë gjatë gjithë jetës, për të rritur aftësitë e të mësuarit, për sukses në mësim dhe të mësuar gjatë gjithë jetës. Në kurs do të trajtohen strategjitë për mësimnxënie të suksesshme, mjetet që ndihmojnë kujtesën, teknika të të mësuarit, shprehitë e mira të studimit, teknikat e të lexuarit për të kuptuarit e saktë të tekstit, strategjitë për të dëgjuarit aktiv dhe mbajtjen e shënimeve, strategjitë për hulumtim dhe evidentim të burimeve, strategjitë për planifikimin dhe menaxhimin efektiv të kohës, strategjitë për menaxhim të ankthit dhe stresit para provimit.

KOMUNIKIMI NË ARSIM

Gjate kursit do te shqyrtohet dinamika e komunikimit interpersonal në mes të subjekteve në mjediset edukative në rrethana institucione,(në veçanti në mes të nxënësve dhe mësimeve, moshatareve, stafit të shkolles, prindi me personelin mesimor etj). Do të fillohet nga këndvështrimi mbi ceshtjet parimore dhe shkathtesite e nevojshme per komunikim te efektshem interpersona, pastaj te vazhdohet me komunikimin nga pikenisja personale , (vetkoncepti dhe te tjeret) qe pasatj te perfundohet me ceshtje me komplekse rreth dinamikës se komunikimit interpersonal ne klimen e realizimit te procesit edukativ arsimor, ne rrethanat institucionale

DREJTSHKRIMI I SHQIPES

Ky kurs u ofron studentëve njohuri të avancuara për gjuhën e sotme standarde shqipe, duke vënë në qendër të vëmendjes vështirësitë e zbatimit të saj të drejtë jo vetëm në shkollë, por edhe në shoqëri. Kursi ua mundëson studentëve thellimin e njohurive për parimet dhe rregullat e drejtshkrimit të shqipes standarde, si dhe zbatimin e tyre në praktikë.

GJUHË ANGLEZE II

Gjuhë angleze II është kurs semestral, i cili si vazhdimësi e kursit Gjuhë angleze I do t'i ekspozojë studentët ndaj një sërë situatash komunikative në gjuhën angleze, nëpërmjet të cilave studentët do t'i përmirësojnë shkathtësitë e tyre komunikuese dhe njëkohësisht do t'i avancojnë katër shkathtësitë themelore gjuhësore: të dëgjuarit, të lexuarit, të folurit dhe të shkruarit, por kësaj rradhe duke përdorur struktura më të ndërlikuara gjuhësore si dhe leksik më të pasur.

EDUKIMI PËR MEDIA

Kursi Edukimi për media trajton llojet dhe funksionet e mediave në shoqërinë bashkëkohore, mundësitë që krijojnë ato për të pasur qasje të shpejtë në rrjedhat e mendimit dhe të informacionit global, si dhe ndikimin e tyre të jashtëzakonshëm në çdo fushë të jetës falë teknologjisë së avancuar dhe hapësirave që ka krijuar ajo për bartjen dinamike të informacionit.

SHKENCAT SHOQËRORE ME METODOLOGJI

Shkencat shoqërore me metodologji, si lëndë studimi përmbajnë integralen e shkencave shoqërore. Kategorinë e shkencave shoqërore e paraqesin disiplinat akademike shkencore, të cilat merren me studimin e jetës shoqërore të grupeve njerëzore dhe të individit. Kjo kategori sintetike përfshinë materjen nga predimensionaliteti i përgjithshëm filozofik, antropologjik, psikologjik, edukologjik.

GJUHË SHQIPE III

Në këtë kurs studentet do të marrin njohuri të reja, duke i zgjeruar njohuritë e tyre paraprake, përkritazi me organizimin e tekstit: objektin e studimit të sintaksës, klasifikimin e togfjalëshave, klasifikimin dhe llojet e fjalive për nga struktura e tyre, modaliteti etj., gjymtyrët kryesore dhe gjymtyrët plotësuese të fjalisë: Po ashtu ata do t'i thellojnë njohuritë e tyre edhe në fushën klasifikimit dhe të llojeve të fjalisë së përbërë (fjalitë e bashkërenditura dhe fjalitë e nënrenditura).

TIK NË EDUKIMIN FILLOR

Ky kurs fokusohet në karakteristikat themelore të sistemit kompjuterik, shfrytëzimin e sistemeve të ndryshme operative për pajisje të ndryshme, shfrytëzimin e programeve aplikative lidhur me zbatimin e tyre në aktivitete arsimore, shfrytëzimin e burimeve të internetit për komunikim dhe informacion, modelimin e aktiviteteve për fëmijë duke shfrytëzuar softverë të ndryshëm arsimor si dhe zbatimin e tyre për lojëra edukative në programin fillor.

METODIKA E EDUKIMI FIZIK

Metodika e Edukimit Fizik u kushton një vend të rëndësishëm parimeve të të mësuarit. Diskutimin mbi to ajo e bën përkrahë diskutimit të parimeve, formave dhe metodave të përgjithshme të edukimit fizik. Parimet e të mësuarit janë ato kërkesa të përgjithshme themelore me karakter shkencor, pedagogjik e psikologjik, mbi bazën e të cilave ndërtohet procesi mësimor, brendia, format, metodat dhe teknikat e të mësuarit në përputhje me qëllimet e metodikes së edukimit fizik. Me përmbajtje të edukimit fizik kuptojmë një sistem të caktuar dijesh me karakter njohës, psikomotor e emocional, të cilat parashikohen për t'u përvetësuar nga nxënësit në mënyrë të përshkallëzuar e sistematike nga klasa në klasë dhe nga cikli në cikël në përputhje me vecoritë e tyre anatomo – fiziologjike e psikologjike.

INTERPRETIMI NË INSTRUMENTE

Lënda është e dizajnuar për t'i përgatitur studentët që të njihen me karakteristikat e instrumenteve muzikore dhe mënyrën e interpretimit në instrumente me tastierë dhe instrumentet fëmijërore (sidomos ato nga grupi i instrumenteve të Orffit). Përmes këtij kursi studentët do të aftësohen të interpretojnë këngë të ndryshme me specifika për nivelin fillor (klasa 1-5). Këngët do t'i demonstrojnë në mënyrë praktike duke aplikuar teknika funksionale të interpretimit.

EDUKIMI PËR QYTETARI DEMOKRATIKE

Edukimi për qytetari demokratike synon përgatitjen e studentëve mbi edukimin, ngritjen e vetëdijes, informimin për të mbrojtur të drejtat dhe përgjegjësitë e fëmijëve në shoqëri, për të vlerësuar diversitetin dhe për të luajtur një rol aktiv në jetën demokratike, për mbrojtjen dhe përparimin e demokracisë dhe të shtetit të së drejtës. Në këtë lëndë përfshihet edhe “Edukimi për të drejtat e njeriut” që nënkupton edukimin, trajnimin, ngritjen e vetëdijes, informimin, praktikën dhe veprimtaritë që ato synojnë, përmes pajisjes së studentëve me njohuri, aftësi dhe qëndrime dhe sjellje që i aftësojnë dhe i fuqizojnë ata për të dhënë ndihmesën e tyre në ndërtimin dhe mbrojtjen e një kulture universale të të drejtave të njeriut në shoqëri, për përparimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore.

STRATEGJITË DHE METODAT E SHKRIM-LEXIMIT

Me anë të këtij kursi synohet të argumentohet se strategjitë, metodat dhe format e mësimit të leximit dhe shkrimit jo vetëm që janë të aplikueshme, por edhe të dobishme në procesin e mësimit dhe nxënies së shkrim-leximit. Kursi jep njohuri të detajuara për strategjitë e mësimit të gjuhës (sipas Oxfordit) dhe ndarjen e tyre, si dhe për metodat dhe format e mësimit të shkrim-leximit

METODOLOGJIA MONTESORI

Ky kurs ka për qëllim që studentët e programit fillor të përgatiten për zbatimin e njohurive fillestare për metodologjinë Montesori gjatë punës me nxënësit. Ky kurs ofron metoda të mësimdhënies dhe të nxënies përmes shfrytëzimit të shqisave për të zhvilluar tek fëmijët konceptet matematikore, zhvillimin gjuhësor dhe komunikimin, zbulimin e botës dhe natyrës, muzikën etj. Qasja montesori është një filozofi bashkëkohore e të nxënies duke vepruar dhe me fëmijën në qendër. Pjesa më e madhe e kursit parashihet të realizohet përmes praktikës në laboratorin Montesori të cilin e posedon Fakulteti i Edukimit.

EDUKIMI PËR NDËRMARRËSI

Në këtë lëndë mundësohet përvetësimi e koncepteve bazë dhe i njohurive të avansuara në fushën e edukimit për aftësitë e nxënësve në ndërmarrësi dhe aktivitete individuale. Kursi realizon aktivitete me studentë lidhur me përgatitjen e planeve individuale dhe zhvillimin e kreativitetit për ndërmarrësi si dhe shtjellohet ndikimi i faktorëve të ndryshëm që nxisin dhe zhvillojnë vetit dhe kreativitetin e studentëve për ndërmarrësi në jetë. Kursi ndihmon studentët në hartimin e planeve biznesit apo edhe të planeve për ide të ndryshme tjera profimprurëse. Projekt idetë mund të jenë nga: ndërmarrësia për ofrimin e shërbimeve në fushën e teknologjisë së informacioneve dhe shërbime tjera, ndërmarrësi në fushat prodhuese, ndërmarrësi në fushat mjedisore. Analiza të ndryshme të studimit të tipeve të individëve (studentëve) qoftë në aspektin social, aspektin e aftësive menaxhuese dhe aspektin e vetive liderë të studentëve.

PRAKTIKA PEDAGOGJIKE II

Praktika pedagogjike II trajton funksionin pedagogjik të praktikës mësimore, objektivat e praktikës mësimore si dhe rolin dhe përgjegjësitë e studentit gjatë mësimit praktik. Rëndësi e posaqme do t'i kushtohet zhvillimit të shkathtësive vrojtuese dhe praktikave të reflektimit. Në kuadër të lëndës do të shqyrtohet: roli i të shkruarit reflektiv, udhëzimet për diskutimin reflektiv, udhëzimet e përgjithshme për të shkruarit reflektiv në ditar, informatat kthyesë në ditar si dhe udhëzimet për ditarët e studentëve mësimdhënës. Gjithashtu studentët do të përgatiten për teknikat e vrojtimit dhe asistimin në orët mësimore. Në kuadër të lëndës, studentët do të marrin pjesë drejtëpërdrejtë në mësimdhënie në shkollë në praktikë 4 javore (20 ditë) duke synuar zhvillimin e shkathtësive vrojtuese dhe praktikave reflektuese. Studentët do të asistojnë mësimdhënësin në çdo hap të organizmit të mësimit dhe me ndihmën e tyre do të planifikojnë dhe mbajnë së paku 4 orë mësimore nga katër lëndë të ndryshme (së paku një orë në javë). Orët e mbajtura mësimore të mbajtura nga mësimdhënësi mentor dhe nga studenti mësimdhënës do të analizohen në mënyrë kritike duke reflektuar për anët e forta dhe nevojat për përmirësim.

LETËRSI PËR FËMIJË

Letërsi për fëmijë, si lëndë në nivelin universitar ka për qëllim t'i njohë studentët e programit fillor me letërsinë për fëmijë si fushë specifike e letërsisë në përgjithësi, si dhe me autorë e vepra që bëjnë vlerat kulminante të saj. Në këtë mënyrë studentët do të njihen me llojet letrare për fëmijë dhe do të aftësohen për punë kërkimore shkencore, duke u aftësuar për bartjen e këtyre njohurive të fëmijët, por edhe të mësimdhënësit e ardhshëm, duke aplikuar metodologji, strategji, parime, kritere, tekniqe e forma të punës që lidhen me punën në institucionet parashkollore, para së gjithash, por edhe me mësimdhënien e letrësisë në shkollë.

SHKENCAT NATYRORE ME METODOLOGJI I

Kursi përmban një shumëllojshmëri të temave dhe nën temave që trajtojnë çështje nga: Astronomia, Fizika, Kima, synon përgatitjen e studentëve që t'i interpretojnë këto njohuri për nivelin e shkollës fillore. Në pjesën e parë të kursit ofrohen përmbajtje thelbësore nga natyra fizike e trupave të Sistemit Diellor, astronomia praktike dhe sferike, ligjet natyrore, trupat e vegjël qiellorë, lëvizjet mekanike, punën dhe energjinë, valët dhe përhapjen e tyre, lëkundjet mekanike, hidrostatikën, dukuritë termike, zërin, dukuritë elektrike, rrymën elektrike, dukuritë magnetike, optiken, molekulat dhe atomet, ajrin, ngrohjen dhe ndotjen globale, reshjet,

elementet kimike, alkoolet, ADN, dozën e rrezatimit. Në pjesën e dytë ofrohen përmbajtje, aktivitete përkitazi me kompleksitetin e procesit të mësimdhënies së shkencave të natyrës.

MATEMATIKA II

Kursi përmban një rishikim të koncepteve elementare algjebrike, shprehjet algjebrike, ekuacionet lineare, grafikun e ekuacioneve lineare, sistemet e ekuacioneve lineare me dy ndryshore dhe zbatimin e tyre. Po ashtu, në këtë kurs do të shqyrtohen kuptimet themelore nga gjeometria elementare si: trekëndëshi, perimetri dhe sipërfaqja trekëndëshe, katërkëndëshi dhe llojet e katërkëndëshave, rrethi, transformimet izometrike, madhësitë dhe matja e tyre, perimetri dhe syprina e sipërfaqeve shumëkëndëshe, trupat gjeometrik, syprina dhe vëllimi i tyre.

DRAMATIZIMI DHE SHFAQJET ME KUKULLA

Me zhvillimin e kësaj lënde mësimore studentët do të aftësohen për zhvillimin e aftësive tek fëmijët dhe plotësimin e kërkesave të tyre për ta lozur rrolin e artistit-kukull të moshave të ndryshme pa kufizim gjinie dhe të njoftohen me personazhet, skenografinë, me stilistikën, dritën, hijen dhe zërin.

Studentët do të përgatiten për përdorimin e dramatizimit dhe lojës me role si metodë e mësimdhënies dhe të nxënit. Do të fitojnë studentët botëkuptime të reja mbi teatrin me kukulla dhe teknikat e punës duke u njohur me punën me materialin didaktik teknikat e punës dhe aplikimin e tyre. Do të zhvillohen aftësitë e tyre kreative në nivel më të lartë për teatrin dhe konkretisht interpretimin me kukullën në duar gjatë leximit të përrallave dhe teksteve të tjera letrare. Rezultatet do të jenë edhe me konkrete duke besuar edhe në korrelacionin me gjinitë e tjera të arteve, si dhe në begatimin e jetës së fëmijut duke marrë pjesë vet në rolin e artistit.

QYTETËRIMI SHQIPTAR

Ky kurs fokusohet në qytetërimin shqiptar, zhvillimin e tij nëpër etapat historike, ndikimet e jashtme, ndikimet religjioze dhe transformimet e brendshme të qytetërimin shqiptar. Temat që përfshihen në këtë kurs janë: krijimi i qytetërimin shqiptar, ndikimet e jashtme, qytetërimi ilir, qytetërimi arbëror, qytetërimi shqiptar dhe krishterizmi, qytetërimi shqiptar dhe islamizmi, qytetërimi shqiptar dhe krijimi i shtetit kombëtar shqiptar, qytetërimi shqiptar përball integritimeve ndërkombëtare dhe globalizmit. Studentët do të bëhen “lexues kritik” në mënyrë që të analizojnë hulumtimet sasiore dhe cilësore në fushën e qytetërimin shqiptar dhe të shfrytëzojnë rezultatet kërkimore në realizimin e hulumtimeve të tyre për përmirësimin e praktikave të mësimdhënies dhe të nxënit.

EDUKIMI SHËNDETËSOR

Ky modul shqyrton shëndetin dhe përcaktuesit e shëndetit, aspektet rregullative vendore dhe ndërkombëtare të aplikueshme për shëndet, burimet dhe mundësitë për edukim shëndetësor, përgjegjësitë e edukatorëve shëndetësor në mësimin për shëndetin dhe promovimin e shëndetit. Perspektivat kulturore në shëndet dhe sëmundje. Bashkëpunimi ndërsektorial dhe multidisiplinar në promovim dhe parandalim të sëmundjeve dhe planifikim të aktiviteteve. Mjediset e shëndetshme. Shkollat promovuese të shëndetit. Shkathtësitë komunikuese të aplikuar në edukimin shëndetësor. Vetitë e edukatorit të mirë. Metodrat dhe mjetet edukativo shëndetësore. Ndikimi i mediave dhe materialeve audio vizuale.

EDUKIMI NË FËMIJËRINË E HERSHME

Gjate kursit do te shqyrtohet aspekti teorik dhe praktik i edukimit të fëmijëve në moshën e fëmijërisë së hershme , sipas teorive të ndryshme shkencore dhe nevojave të fëmijës. Roli i domosdoshëm dhe sfidues i edukatorit kompetent, rrugët e ndryshme të edukimit përgjatë historisë, si dhe programet e ndryshme të edukimit, janë çështje të cilat duhet kuptuar nga studenti. Analiza e njohurive , shprehive dhe shkathtësive, bindjeve e qëndrimeve të edukatorit në harmoni me nevojat dhe qëllimet e edukimit por edhe me vlerat e standartet e pranuar për edukim parashkollor në nivel kombëtar e ndërkombëtar, do sjellin mundësinë e krijimit të filozofisë personale për edukimin në fëmijërinë e hershme,

SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT ME FEMIJE

Kursi realizohet në formë të punëtorisë dhe synon që të zhvillojë teorikisht dhe praktikisht njohuri lidhur me konceptet dhe modelet kryesore të komunikimit dhe punës me fëmijët, dhe të kuptuarit e llojeve të ndryshme të komunikimit të fëmijëve. Kursi shtjllon më tutje njohuritë e fituara paraprakisht në kurset e tjera, për t'i aftësuar studentët të zbatojnë ato njohuri në ndërveprimin që kanë me fëmijët. Kursi shtjllon teorinë dhe hulumtimet më të reja për format e komunikimit dhe ndikimet ndërpersonale në komunikimi duke vënë vazhdimisht theksin tek komunikimi me fëmijë dhe përvetësimi i shkathtësive të nevojshme në edukim. Kursi është i dizajnuar të zhvillojë shkathtësitë e studentëve për të komunikuar dhe ndërvepruar me fëmijë, për të nxitur bashkëpunimin dhe për zgjidhje të konflikteve, të zhvillojë aftësitë intrapersonale dhe interpersonal të studentëve, të zhvillojë aftësitë e empatisë dhe të dëgjuarit aktiv dhe të zhvillojë të menduarit kritik të studentëve.

BAZAT E HULUMTIMIT NË EDUKIM

Ky kurs fokusohet në paradigmat, çështjet dhe metodat e hulumtimeve në edukim. Temat që përfshihen në këtë kurs janë: përkufizimi i metodave të ndryshme të hulumtimeve, analiza kritike e literaturës, grumbullimi i të dhënave sasiore dhe atyre cilësore nga mjediset e të nxënit, natyra dhe llojet themelore të hulumtimeve, të lexuarit kritik dhe interpretimi i hulumtimeve. Studentët do të bëhen “lexues kritik” në mënyrë që të analizojnë hulumtimet sasiore dhe cilësore në fushën e edukimit dhe të shfrytëzojnë rezultatet kërkimore në realizimin e hulumtimeve të tyre për përmirësimin e praktikave të mësimdhënies dhe të nxënit.

PSIKOLOGJIA E EDUKIMIT

Kursi ofron njohuri për të nxënë dhe punën psiko-edukative me fëmijët. Kursi do të trajtojë çështje mbi edukimin e fëmijëve që nga lindja deri në moshën shkollore, zbatimin e psikologjisë në studimin të nxënit, punës direkte me fëmijët, motivimit dhe çështjeve tjera, që ndërlidhen me procesin e edukimit si dhe aplikimin praktik të parimeve psikologjike në punën direkte me fëmijët, dhe i mundëson studentëve të ndërtojnë dhe rindërtojnë teorinë personale të të mësuarit përgjatë këtij kursi. Theks i veçantë do të vendoset tek të nxënit, motivimi, kreativiteti në klasë, dhe ndikimet që ka mjedisi tek sjellja e fëmijës.

PRAKTIKA PEDAGOGJIKE III

Ky kurs, është vazhdimi e kursit praktika pedagogjike II dhe synon që studentët të zhvillojnë njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet e caktuara për të qenë mësimdhënës në nivelin e shkollës fillor dhe të zhvillojnë të menduarit kritik përgjatë zbatimit të kurrikulës përmes proceseve të planifikimit, lidhjeve teori me praktikë dhe reflektimit të cilat shpiejnë drejt zhvillimit të tyre

si mësimdhënës. Kjo pjesë përfshinë edhe zhvillimin e aftësive për të krijuar dhe menaxhuar një ambient kultivues dhe përkrahës të nxënies dhe për të planifikuar dhe mbajtur mësim sipas planprogramit të shkollës si dhe për t'u njohur me funksionimin e shkollës si organizatë. Studentët do të qëndrojnë në shkollë 6 javë rresht dhe do të prfshihen aktivisht në secilën pjesë të planifikimit dhe organizimit të mësimi.

ARTET FIGURATIVE ME METODOLOGJI

Në kuadër të kësaj lënde, studentët e programit fillor do të përfitojnë njohuri themelore për artet figurative, konceptet e përgjithshme të cilat janë të organizuara në katër dimensione themelore si: Krijimtaria dhe performanca artistike, gjuha dhe komunikimi artistic, relacioni art - shoqëri dhe çmuarja dhe vlerësimi estetiko-artistik. Studentët do të inkurajohen që të shfrytëzojnë artet jo vetëm si krijimtari kreative dhe për zhvillim të imagjinatës por edhe si metodologji të punës me fëmijë në secilën lëndë të kurrikulës duke integruar këtë fushë me të gjitha fushat e tjera të kurrikulës.

SHKOLLA FAMILJA DHE KOMUNITETI

Kursi ofron njohuri për teorinë dhe praktikën e bashkëpunimit të shkollës, familjes dhe komunitetit në promovimin e të edukimit, nxënies dhe performancës akademike të nxëniesit në shkollë. Përmes kursit, studentët do të identifikojnë strategji dhe praktika që kanë rezultuar të frytshme në partneritetet mes shkolles, familjes dhe komunitetit. Kursi fokusohet në çështje mbi rolet e mësimdhënësve në bashkëpunim me disiplina tjera me qëllim të mbështetjes së familjeve dhe ndërtimin e partneriteteve. Theks i vecantë do vendoset në studimin e mardhënies midis fëmijës, familjes, komunitetit dhe mësimdhënësve duke përfshi këtu studimin e edukimit të prindërve dhe përfshirjen, jetesën e familjes dhe komunitetit, abuzimin e fëmijës dhe çështje aktuale të jetës familjare. Dëgjimi efektiv dhe teknikat e komunikimit janë një ndër çështjet që trajton kursi në mënyrë që të arrihet të shpjegohet më mirë sjellja dhe kognicioni njerëzorë, efektiviteti i partneritetit në procesin e të mësuarit, interesimit dhe përkushtimit të nxënësve në nxënë. Kursi trajton dhe rritjen intelektuale dhe emocionale të familjes, mësimdhënësve dhe komunitetit përmes strategjive të ndryshme, me synim të produktivitetin në partneritetet të këtyre faktorëve por dhe për menagjimin e situatave të vështira.

STRATEGJITË BASHKËKOHORE TË MËSIMDHËNIES

Ky kurs trajton aspektet të mësimdhënies efektive, përmbajtje aktuale për të nxëniesit si proces kognitiv dhe parakushtet që e mundësojnë të nxëniesit si proces intelektual. Gjithashtu, në kurs trajtohen teknikat dhe praktikat e reja të domosdoshme për motivimin e nxënësve për të nxënë të suksesshem. Trajtohen qasjet bashkëkohore për punë me nxënës si dhe filozofit e ndryshme me nxëniesin në qendër: të nxëniesit në bashkëpunim, të menduarit kritik gjatë leximit dhe shkrimit, të nxëniesit e bazuar në probleme, të nxëniesit e bazuar me projekte, të nxëniesit heuristik, të nxëniesit e bazuar në hulumtim etj.

SHKATHTËSITË PËR JETË

Kursi ka për synim të ofroj fëmijut hapësirë të gjithëmbarshme për zhvillimin e shkathtësive të ndryshme për jetë dhe punë. Kursi shkathtësitë për jetë dhe punë shtjellon zhvillimet e gjithëmbarshme të fëmijut, ndërveprimet e tij me individët tjerë, ndërveprimet me mjedisin ku ai jeton si dhe ndikimet e tilla në zhvillimin e tij. Në këtë kurs studentët njihen me mjedisin

jetësor dhe me materialet e ndryshme që na rrethojnë në natyrë, përdorimin e materialeve me fëmijë për krijimin e figurave apo objekteve të ndryshme me punë individuale apo grupe si dhe nxitjen e dëshirës për punë kreative nga materialet e ndryshme nëpër qerdhe apo në institucione parashkollore. Përmes projekteve grupe dhe individuale ushtrohet zbatimi i materialeve si: letra, argjili, gipsi, sapuni, plastelina, qiri, produktet ushqimore, etj. Projektet ndijmojnë fëmijët, stimulojnë dhe rrisin nxitjen e dëshirës për punë kreative të shkathtësive të tyre për punë në jetë.

METODOLOGJI E LEXIMIT LETRAR

Kursi mëton t'u mundësojë studentëve studimin e metodave, të modeleve, të teknikave dhe të strategjive të mësimdhënies dhe të nxënimit të letërsisë shqipe. Studimin e të shkruarit dhe të lexuarit letarar. Njohjen me sistemin estetik, me konceptet didaktike të leximit dhe të përpunimit të teksteve letrare në shkollë. T'u mundësojë të bëhen hulumtues të veçorive letrare, historike dhe estetike të teksteve letrare. Krijimin e veçorive dhe të praktikave të mësimdhënies dhe të nxënimit të teksteve letrare të periudhave të ndryshme.

HISTORIA E ARSIMIT KOMBËTAR

Kursi synon t'u prezentojë studentëve historinë dhe të kulturës shqiptare në aspektin kronologjik dhe përbajtësor, duke filluar nga ilirët e deri tek pavarësia e Kosovës.

Kursi përgadit studentët që të njohin arsimin dhe kulturën e popullit shqiptarë gjatë Rilindjes Kombëtare Shqiptare, sidomos luftës dhe përpjekjeve të popullit dhe patriotëve shqiptarë për zhvillimin e arsimit kombëtar dhe për hapjen e shkollave në gjuhën shqipe. Tema tjera që përfshihen në këtë kurs paraqesin arsimin dhe kulturën gjatë periudhës së Luftës së Parë Botërore, përpjekjet për demokratizimin dhe laicizimin e shkollës në vitet 1920-1924; arsimin dhe kulturën në periudhën 1925-1939; historinë e zhvillimit të arsimit dhe dhe kulturës që nga Lufta e Dytë Botërore e deri në fund të viteve 1980; historia e arsimit gjatë viteve të 90-ta e deri më sot në Kosovë.

EDUKIMI GJITHËPËRFSHIRËS

Njohuritë mbi nocionet dhe bazat e edukimit gjithëpërfshirës; Plani Individual i Arsimit dhe Indeksi për Gjithëpërfshirje; Diverziteti kulturor, shoqëror, stilet e të nxënimit, etj.

SHKENCAT E NATYRËS ME METODOLOGJI II

Mësimdhënia dhe të nxënimit mbi botën e gjallë paraqet diversitet të vendeve të zbatimit, strategjive të shumta dhe teknikave specifike. Qëllimi i kursit është që studentët-mësimdhënës të pajisen me njohuri bazë shkencore mbi jetën e gjallë si dhe të zhvillojnë shkathtësi praktike të përdorimit të strategjive, metodave dhe teknikave të mësimdhënies në klasë, laborator dhe natyrë për të arritur rezultatet e të nxënimit për konceptin "Bota e gjallë". Kursi ndihmon studentët për të arritur kompetencat për mësimdhënien e biologjisë me qasjen nxënësi në qendër dhe si koncept i integruar brenda fushës Shkencat e natyrës në nivelin fillor.

MËSIMDHËNIA E MATEMATIKËS I

Ky kurs është i dizajnuar për të përgatitur mësimdhënësit e ardhshëm të shkollës fillore për mësimdhënie të matematikës. Gjatë këtij kursi, studentët do të zbulojnë se si fëmijët mendojnë dhe mësojnë të arsyetojnë dhe komunikojnë matematikisht dhe të zgjidhin probleme duke përdorur strategji të ndryshme. Studentët do të marrin përvojën e duhur për zhvillimin e

koncepteve për numrat dhe numërimin, modelet për vend-vlerën e shifrave të numrave natyrorë, zhvillimin e të menduarit për veprimet themelore dhe numrave thyesorë. Në këtë kurs do të shqyrtohen edhe teoritë e të nxënimit të matematikës, strategjitë e mësimdhënies, mësimdhënia përmes zgjidhjes së problemeve, planifikimi, shfrytëzimi i mjeteve të konkretizimit, manipulativeve dhe teknologjisë (programeve aplikative).

METODOLOGJI E GJUHËS DHE LETËRSISË SHQIPE

Kursi fokusohet në shqyrtimin e procesit të mësimdhënies dhe të nxënimit të gjuhës dhe letërsisë shqipe, analizën e aspekteve teorike dhe të praktikave të mësimdhënies. Temat që përmban kursi përfshijnë bazat themelore për zhvillimin e të kuptuarit në gjuhë amtare, teoritë e të nxënimit të gjuhës, planifikimin për zhvillimin e koncepteve themelore për shkronjat, rrokjet, fjalët. fjalitë e periudhat, tekstin etj., planifikimin për të kuptuarit e leximit dhe gramatikës së gjuhës shqipe nga ana e nxënësve si dhe zhvillimin e komunikimit në përgjithësi. Studentët do të bashkëpunojnë për të shqyrtuar probleme të ndryshme, do të analizojnë situata të ndryshme dhe do të përgatiten për të zbatuar mësimdhënien me nxënësin në qendër, të bazuar në parimet kryesore të Kornizës Kurrikulare dhe Kurrikulën bërthamë për klasat përgatitore dhe arsimin fillor.

STATISTIKA ELEMENTARE

Në kursin Statistika elementare shqyrtohen konceptet themelore të statistikës: Pupollacioni, mostra, mesatarja, mediana, moda, histogramet, masat e vendndodhjes qëndrore, varianca, devijimi standard, pozita relative e të dhënave, rregulla empirike, konceptet bazike mbi probabilitetin, shpërndarjet e ndryshoreve të rastit, lakorja normale, korelacioni, shpresa matematikore, intervalet e besueshmërisë dhe testimi i hipotezave.

PROCESET PSIKIKE DHE PERSONALITET

Kursi është i dizajnuar në mënyrë që të njoftojë studentët me proceset psikike dhe personalitetin, dhe zbatimin e tyre në jetën e përditshme. Kursi shtjellon teoritë themelore psikologjike dhe metodat e studimit të saj, njohuritë e proceseve bazike kognitive, emocionale dhe biheviorale sipas gjurmimeve empirike, dhe analizën e llojllojshmërisë së faktorëve që ndikojnë ndijimet, perceptimet, të mësuarit, kujtesën, motivimin, ndjenjat dhe shëndetin. Kursi bën diferencimet në mes të informatave shkencore dhe jo-shkencore rreth sjelljes njerëzore dhe proceseve mendore, dhe përshkruan proceset psikologjike që ndërveprojnë tek fëmija. Kursi shtjellon në detaje personalitetin si konstrukt dhe zhvillimin e personalitetit të fëmijës. Njohuritë nga kursi u ofrojnë studentëve një perspektivë të plotë mbi botën, njohjen e vetes dhe të tjerëve dhe të kuptuarit e kompleksitetit të sjelljes njerëzore, dhe do të fokusohet në ngritjen e shkathtësive të studentëve për të zbatuar konceptet dhe parimet psikologjike në situata të punës dhe jetës së përditshme.

MËSIMDHËNIA E DIFERENCUAR DHE PIA

Njëra ndër sfidat me rëndësi në mësimdhënien e sotme është aftësia për t'u përgjigjur në mënyrë pozitive dhe proaktive ndaj dallimeve ndërmjet nxënësve, pra ndaj diversitetit në klasë. Prandaj, përmes kësaj lënde do të adresohen çështjet e përmendura duke vënë theksin në mësimdhënien e diferencuar ose adaptive dhe në planin, përkatësisht programin e individualizuar për ata nxënës të cilët janë në rrezik për të dështuar në shkollimin e tyre. Mësimdhënia e diferencuar përcaktohet si një punë mësimore e cila përshtatet mbi bazën e

karakteristikave dhe nevojave individuale të nxënësve. Të dhënat tregojnë se nëse zbatohet si duhet, mësimdhënia e diferencuar mund të ketë ndikim në përmirësimin e rezultateve të të nxënësve.

ETNOLOGJI ME LETËRSI LETËRSI POPULLORE

Kursi mëton t'u mundësojë studentëve studimin e shfaqjes, e zhvillimit, e organizimit të stileve të jetesës dhe të zakoneve, të kulturës materiale dhe shpirtërore përkitazi me format e ndryshme kulturore të krijuara nga populli ose për popullin dhe që kanë veti të popullit, me elementet e kulturës shoqërore, me studimin e familjes, me studimin e formave të ndryshme të organizimit të shoqërisë, me studimin e rregullave zakonore të komuniteteve shoqërore në përgjithësi, e në veçanti me ato të popullit shqiptar. Njohjen me historinë folkloristike gjithëbotërore dhe shqiptare duke i drejtuar në analizën e strukturave artistike dhe të vlerave të folklorit letrar sipas gjinive dhe zhanreve. T'u japë njohuri bazë rreth trashëgimisë historike në fushë të artit letrar gojor. Njohjen e mirë me gjurmët e pasura të jetës shpirtërore të popullit shqiptar, duke u dhënë njohuri të nevojshme nga letërsia popullore si formë e veçantë e krijimtarisë imagjinatave letrare.

MËSIMI NË NATYRË

Kursi ka për qëllim adresimin e rolit dhe zhvillimit të aktiviteteve në natyrë me qëllim të nxitjes së kuriozitetit, kreativitetit, vëzhgimit dhe zhvillimit të mendimit kritik tek fëmijet. Kursi ka për qëllim që studentin ta pajisë me njohuri si të bëjë ndërlidhjen e fenomeneve natyrore me konceptet shkencore përmes eksplorimit, lojës, ekzaminimit, vëzhgimit dhe të mësuarit. Në këtë kurs studenti do të fitojë njohuri bashkëkohore mbi natyrën dhe ndërlidhjen e njeriut me natyrën, evolucionin e natyrës dhe pozitën e njeriut në natyrë, vlerat që merr njeriu nga natyra dhe si ndikon në natyrë. Poashtu studenti do të fitojë bazë të njohurive për eksplorimin e fenomeneve duke argumentuar, qasje e cila ndihmon në të shkruar, komunikim dhe reflektim ndaj koncepteve shkencore. Duke pasqyruar edhe njohuritë e studentëve të fituara në kurset paraprake, kursi do të fokusohet poashtu edhe në zhvillimin e aktiviteteve që kanë për qëllim ndërlidhjen e natyrës me konceptet shkencore, duke i bërë fëmijët protagonist kryesor të interaksionit (ndërveprimit) me natyrën.

VLERËSIMI NË ARSIM

Kursi ka për qëllim përgatitjen e studentëve për të përcjellur dhe vlerësuar përparimin e nxënësve dhe zhvillimin e kompetencave, duke përdorur teknika të ndryshme të vlerësimit të vazhdueshëm. Gjatë kursit do të shqyrtohen çështje të tilla si: rëndësia e vlerësimit në arsim, qasjet teorike rreth vlerësimit në arsim, njohja dhe zotërimi i aftësive për zbatimin e teknikave formale për vlerësim siç janë: dosja e punës së nxënësve, performanca e tyre, lista e kontrollit, regjistrime të ndryshme të sjelljes përmes magnetofonit, kamerave, fotove, vizatimet e fëmijëve, si dhe planifikimi i procedurës së vlerësimit. Peshë të veçantë në vlerësim ka dhe përpunimi i të dhënave të mbledhura përmes këtyre teknikave. Qëllimi i kursit është njohja e studentëve me përvojat që përfshijnë strategjitë, të cilat çojnë në vlerësimin autentik, diagnostik, formativ, përmbledhës.

LETËRSI KOMBËTARE

Lënda përfshinë gjithë prodhimtarinë letrare artistike të shkrimtarëve më përfaqësues të popullit tonë, krijimtari e cila përkufizohet me katër periudha të mëdha të zhvillimit dhe të formësimit të saj. Ajo shpreh specifikat dhe rëndësinë e saj në kontekstin letrar historik të zhvillimit të letërsisë shqipe dhe të veçantive të gjinive, llojeve e zhanreve letrare, si dhe lidhshmërinë e saj me zhvillimin e përgjithshëm kulturor dhe qytetëruës shqiptar. Elemente këto parësore të krijimit të veçantive individuale të secilit mësimdhënës të Republikës së Kosovës.

MËSIMDHËNIA E MATEMATIKËS II

Lënda Mësimdhënia e matematikës II shqyrtohen përgjithësimet, modelet dhe funksionet si bazë për zhvillimin e të menduarit kritik e krijues. Zhvillimi i të menduarit gjeometrik dhe koncepteve themelore gjeometrike duke konsideruar nivelet e Van Heiles, të nxënimit për figurat dhe vetitë, konceptet fillestare për matjet dhe të nxënimit për transformimet gjeometrike zënë një vend parësor në kurs. Në kurs, do të shqyrtohen edhe konceptet themelore për të dhënat dhe elementet statistikore dhe zhvillimi i koncepteve të probabilitetit. Të gjitha aktivitetet që do të zhvillohen gjatë kursit, mbështeten në mësimdhënien e bazuar në hulumtime, mësimdhënien e bazuar në probleme/projekte dhe zgjidhjen e problemeve me qëllim të përgatitjes së studentëve për mësimdhënës efektiv.

EDUKIMI PËR ZHVILLIM TË QËNDRUESHËM

Nevoja për zhvillim të qëndrueshëm është ndër sfidat e shoqërisë njerëzore sot përfshirë shoqërinë kosovare. Kursi ofron njohuri teorike për zhvillimin e qëndrueshëm si koncept zhvillimor global dhe shkathtësi praktike për zhvillimin e edukimit për zhvillim të qëndrueshëm. Kursi do zhvilloj kompetencat për të zbatuar strategji bashkëkohore të të nxënimit për qëndrueshmëri si: qasja holistike, të menduarit sistemik dhe kritik, të nxënimit me hulumtim, mësimdhënia e integruar, pjesmarrjen në vendimmarrje si qytetar aktiv dhe të përgjegjshëm.

VËSHTIRËSITË NË TË NXËNË

Njohuritë mbi nocionet themelore në fushën e vështirësive në të nxënë; Definicionet dhe karakteristikat e vështirësive në të nxënë; Llojet e vështirësive në të nxënë dhe trajtimi i tyre Ndikimi i vështirësive në të nxënë në performancën akademike, psikologjike dhe sociale të nxënësit – Identifikimi dhe intervenimi i hershëm.

MENAXHIMI I KLASËS

Kursi është dizajnuar në mënyrë që studentët të kuptojnë domethënien e menaxhimit të klasës adresimin e udhëzimeve relevante për një funksionim të efektshëm të klasës. Në këtë kurs trajtohen tema që i referohen teorive dhe praktikave të mira për menaxhimin e klasës të ndërlidhura me veprimet e mësimdhënësit për të organizuar hapsirën, kohën, materialet etj. Të cilat sigurojnë një efektivitet në procesin e të nxënimit dhe mësimdhënies. Gjithashtu, në kuadër të këtij kursi trajtohen tema që ndërlidhen me klasat e stërngarkuara dhe komplekse, vendosjen e rregullave dhe procedurave, ndarjen e përgjegjësisë në klasë, nxitjen e bashkëpunimit midis nxënësve, stilet e mësimdhënësit s imenaxhues i klasës dhe menaxhimin e sjelljeve penguese në përgjithësi.

EDUKIMI PERMES STEAM

Përmbajtja e shkurtër) Ky kurs ofron njohuri dhe shkathësi për mbështetjen e paraqitjes së STEM (Shkencës, Teknologjisë, Inxhinierisë dhe Matematikës) në të gjithë mjediset shkollore. Kursi Edukimi për STEM ka një qasje ndërdisiplinore të nxënies ku konceptet rigorozë akademike shoqërohen me mësim të botës reale ku studentët aplikojnë shkencë, teknologji, inxhinieri dhe matematikë në kontekste që krijojnë lidhje midis shkollës, komunitetit, punës dhe ndërmarrjes globale. Mësimdhënësit e ardhshëm do të mësojnë të mbështesin zhvillimin e aftësive STEM përmes qasjeve aktive, të angazhuara dhe zbatimëse për secilën temë, duke u përputhur me kurrikulën dhe duke angazhuar praktikën më të mirë të mësimdhënies siç janë: mësimdhënia e bazuar në hulumtim, në projekte dhe në probleme. Një nga synimet kryesore të këtij kursi është zhvillimi dhe fuqizimi i mësimdhënësve të rinj për edukimin për STEM.

ZHVILLIMI PROFESIONAL I MËSIMDHËNËSVE

Kursi është përgatitur me synimin që studentët e nivelit master të arrijnë të kuptuarit e proceseve të të mësuarit nga ana e mësimdhënësve duke ndërlidhur këtë me kërkesat ndaj mësimdhënësve për profesionalizim të punës së mësimdhënësit. Kursi do të ofrojë pjesëmarrësve një mundësi për në shqyrtim mbi modelet e ndryshme të zhvillimit profesional dhe zgjedhjet që mund të bëjnë menaxherët e shkollave dhe sistemeve të arsimit në funksion të zhvillimit të një mekanizmi të qëndrueshëm të zhvillimit profesional të mësimdhënësve si një mjet për përgaditje profesionale të mësuesve. Kursi ofron mundësi për studentët që të kuptojnë kontekstin e zhvillimit profesional të mësimdhënësve në Kosovë dhe aspektet e organizimit të aktiviteteve të zhvillimit profesional.

LOJËRAT MATEMATIKORE

Ky kurs ofrohet në formë të punëtorisë me qëllim të angazhimit të studentëve në zhvillimin e shkathtësive për mësimdhënie të matematikës përmes lojërave dhe aktiviteteve kreative. Studentët punojnë me manipulative dhe teknologji për të eksploruar matematikën, zgjidhjen e problemeve, dhe për të mësuar mënyra të ndryshme se si të zhvillojnë tek fëmijët të kuptuarit e përmbajtjeve matematikore

FILOZOFI E EDUKIMIT

Ky kurs do t'u ofrojë studentëve mundësinë për të shqyrtuar një sërë çështjesh edukative nga këndvështrimi filozofik dhe historik. Kursi trajton lëndën dhe konceptet themelore të filozofisë së edukimit, funksionet dhe determinantet historike të edukatës, historinë e edukimit dhe të shkollës në shoqërinë antike, konceptet e filozofëve antik (Sokrati, Platoni, Aristoteli), idetë dhe kontributi i pedagogëve të mëdhenj (Komenskit, Rusoit, Pestalocit etj.), filozofitë dhe teoritë bashkëkohore të edukimit: filozofia pragmatiste e Xh. Djuitt, progresivizmi, qasja bihevoriste e të nxënies, teoria kognitiviste, konstruktivizmi dhe mësimdhënia konstruktiviste, teoria humaniste e të nxënies, trendet bashkëkohore të filozofisë së edukimit.

PRAKTIKA PEDAGOGJIKE IV

Praktika pedagogjike IV është vazhdimi i praktikave të më parë dhe njësoj ka për qëllim zhvillimin e shkathtësive të mësimdhënies së pavarur tek studentët e programit fillor. Praktika pedagogjike, organizohet në dy forma: në shkollë, me pjesëmarrje aktive të studentit në tërë procesin e mësimdhënies dhe në fakultet në ligjerata dhe ushtrime, përmes reflektimit nga vet praktika e drejtëprdrejtë. Aktivitetet gjatë Praktikës pedagogjike IV: studentët duhet të

angazhohen në secilin nga aktivitetet në klasë. Studentët duhet të shënojnë planifikimet dhe reflektimet në ditarët e tyre për aktivitetet në të cilat kanë marrë pjesë.

PROVIMI PËRFUNDIMTAR/PUNIMI I DIPLOMËS

Punohet në bashkëpunim me profesorin mentor sipas rregullores së Fakultetit të Edukimit për studime Bachelor, bazuar në doracakun e Fakultetit të Edukimit për përgatitjen e temës së diplomës.